

PROJEKTET NË ZBATIM THIRRJA E 1^{RË}

GRANT-MARRËSIT ORGANIZATA JO FITIM-PRURËSE

Nr	Organizata	Projekti	Përshkrim i Shkurtër	Kohëzgjatja (muaj)	Zona e Zbatimit
1	Forumi i Mendimit të Lirë	Monitorimi i bashkisë për realizimin e premtimeve elektorale dhe rritja e pjesëmarrjes qytetare në qeverisje dhe llogaridhënie përmes mediave dhe rrjeteve sociale	Përballja e kryetarëve të bashkive përpara përgjegjësisë për realizimin e premtimeve elektorale, duke prodhuar një model ballafaqimi me zgjedhësit. Realizimi i mekanizmeve për pjesëmarrjen e qytetarëve në procesin e llogaridhënies si dhe përfshirja e mediave e disa formave të medias (si faqe interneti dhe reportazhe) në monitorimin e punës së bashkisë.	12	Tiranë, Elbasan, Vlorë, Lezhë
2	Instituti Shqiptar i Medias	Testimi i zbatimit të ligjit të ri të drejtës së marrjes së informacionit nga administrata e re lokale	Përmirësimi i transparencës dhe llogaridhënies së qeverisjes lokale dhe institucioneve publike vendore nëpërmjet një roli më aktiv të medias lokale dhe qytetarëve nëpërmjet: a) Testimit të zbatimit të Ligjit të ri për Informimin e Publikut nga ana e administratës së re lokale; b) Përmirësimit të njohjes dhe aftësisë të gazetarëve lokalë për këtë kuadër legjislativ nëpërmjet testimit të tij në praktikë; c) Përmirësimit të kapaciteteve të autoriteteve lokale për të zbatuar detyrimet e tyre për transparencë dhe përgjegjëshmëri nëpërmjet advokimit për zbatimin e legjislacionit për të drejtën e informimit.	12	Berat, Lezhë, Sarandë, Gjirokastrë, Kukës, Pogradec, Mat
3	Rrjeti ballkanik për Gazetari Investigative, Shqipëri/BIRN	Forcimi i partneritetit vendor midis medias dhe shoqërisë civile	Rritja e llogaridhënies së qeverisë vendore përmes fuqizimit të bashkëpunimit mes aktorëve të shoqërisë civile dhe gazetarëve lokalë. a) Fuqizimi i kapaciteteve të medias lokale përmes trajnimit dhe publikimeve lidhur me mirëadministrimin dhe transparencën e pushtetit vendor, si dhe raportimin sa më të plotë mbi problematikat e komuniteteve lokale dhe promovimit të shembujve pozitivë.; b) Nxitja e transparencës dhe llogaridhënies së institucioneve të pushtetit vendor përmes monitorimit të vazhdueshëm të programeve të transparencës në 61 bashkitë e vendit, c) Forcimi i bashkëpunimit dhe kapaciteteve të aktorëve të shoqërisë civile në advokimin e çështjeve të rëndësishme për komunitetin përmes tryezave rajonale; d) Rritja e nivelit të informimit të qytetarëve mbi çështje të lidhura me pushtetin vendor dhe promovimi i aktorëve të ndryshimit.	12	Kombëtare
4	Intituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim IDM	Tirana Flet	Zhvillimi i demokracisë pjesëmarrëse dhe mirëqeverisjes lokale përmes aktivizimit komunitar vullnetar në zonat urbane të vendit. Rritja e ndërgjegjësimit dhe mobilizimit të komuniteteve vendore dhe grupeve të ndryshme të interesit rreth organizimit vullnetar komunitar në zonat urbane të vendit.	12	Tiranë, dhe 11 bashki të tjera qendër qarqesh
5	Instituti për Kërkime dhe Alternativa Zhvillimi (IDRA)	Zhvillimi i Qasjeve Inovative për përfshirjen e Komuniteteve në Qeverisjen Vendore	Identifikimi i Qasjeve Inovative për një përfshirje sa më efektive të qytetarëve/komuniteteve në vendimarrje lokale. a) Vlerësimi i tipologjisë së mekanizmeve ekzistues për përfshirjen e qytetarëve/komuniteteve të përdorura në të kaluarën; b) Identifikimi i praktikave më të mira/suksesshme që mund të aplikohen në Shqipëri në nivel lokal; c) Propozimi i teknikave të reja inovative për përfshirjen e qytetarëve në vendimarrje; d) Përgatitja e një Udhërrëfyesi për përfshirjen efektive të qytetarëve/komuniteteve për aktorët që duan të përfshihen në procese të tilla; e) Koordinimi dhe zbatimi i 2 projekteve pilot në bazë të Udhërrëfyesit për përfshirjen efektive të qytetarëve/komuniteteve, për përfshirjen e komunitetit në vendimarrje.	9	Shkodër, Tiranë, Durrës, Elbasan, Fier, Korçë
6	Instituti i Studimeve Politike	Bashki e Hapur	Nxitja e zbatimit të ligjit për të Drejtën e Informimit nga administrata e bashkive të reja si kusht kryesor për qeverisje transparente, të hapura dhe më pranë publikut dhe inkurajimin e qytetarëve për të përdorur këtë të drejtë. a) Monitorimi dhe pasqyrimi i situatës të zbatimit të ligjit për të drejtën e informimit që konsiston në monitorimin e njoftimeve zyrtare, faqes së internetit, regjistrave të kërkesave dhe afateve, procedurave, zbardhjes në kohë të publikimit të vendimeve të Këshillave Bashkiakë; b) Nxitja e krijimit të Bashkive të hapura duke stimuluar publikimin e Programit të Transparencës dhe instrumentet e tjera të përcaktuara nga ligji për të drejtën e informimit në bashkitë e reja; c) Angazhim dhe nxitje e qytetarëve për të përdorur të drejtën e informimit, si instrument kryesor në funksion të demokracisë vendore.	12	Tiranë, Durrës, Shkodër, Vlorë

PROJEKTET NË ZBATIM THIRRJA E 1 ^{RË}					
GRANT-MARRËSIT ORGANIZATA JO FITIM-PRURËSE					
Nr	Organizata	Projekti	Përshkrim i Shkurtër	Kohëzgjatja (muaj)	Zona e Zbatimit
7	La Casa nel Cuore	Rritja e pjesëmarrjes rinore në qeverisjen vendore (Këshilli Bashkiak Rinor Peqin)	Rritja e pjesëmarrjes së të rinjve në vendimmarrjen lokale për çështje që i përkasin të rinjve në Bashkinë e Peqinit nëpërmjet ngritjes së një Këshilli Bashkiak Rinor në Bashkinë e Peqinit Këshilli bashkiak Rinor do të këshillojë dhe do të ushtrojë presion pranë Bashkisë Peqin në planifikimin dhe buxhetimin e aktiviteteve dhe adresimin e problematikave që të rinjtë identifikojnë: a) Ngritja e kapaciteteve të të rinjve të cilët do të jenë pjesë e Këshillit Bashkiak Rinor Peqin, në mënyrë që ata t'i përgjigjen sfidave të kësaj sipërmarrjeje; b) Hartimi i planit Lokal të Veprimit për të rinjtë dhe disa politikave sektoriale c) Institucionalizimi i Këshillit Bashkiak Rinor si një organ këshillimor pranë Këshillit Bashkiak.	12	Peqin
8	Një zë i barabartë Rome-Egjiptianë në Komunitetin Vlonjat	Angazhohu –Informohu-Mëso-Vepro ne te mirën e Komunitetit”	Te rinjtë dhe te rejat e komunitetit Rom - Egjiptianë të jenë aktivë në politikëbërje dhe të dëgjohej zëri i tyre. Nxitja e advokimit pranë pushtetit vendor për të adresuar problemet që ky komunitet ka si prioritare. Bashkëpunimi me bashkinë për të zgjidhur problemet dhe për të qënë palë e interesuar gjatë buxhetimit vjetor.	10	Vlorë
9	Instituti i Studimeve Publike & Ligjore	Modeli Win-Win për Pjesëmarrje Qytetare në Qeverisjen Vendore	Përpjekjet në kuadër të projektit do të përqëndrohen në sigurimin e një procesi efikas dhe nxitjen e një roli aktiv të qytetarëve sipas Modelit Win-Win në bashkitë pilote. Modeli Win-Win presupozon zhvillimin e një procesi të përbashkët me komunitetin në përzgjedhjen dhe zbatimin e programeve ose projekteve vendore, ku secila palë, nga këndvështrimi i saj, shpalos idetë dhe merr angazhime, kontraktuale ose jo, për projekte të qeverisjes vendore, ku secila prej tyre përfiton diçka dhe nuk humbet asgjë. Projekti synon a) Identifikimin e nevojave dhe përparësive të qytetarëve (si dhe zbatimi i projekteve për adresimin e tyre) në bashkitë ku zbatohet në lidhje me programet e zhvillimit vendor, nëpërmjet përdorimit të metodave dhe procedurave të Modelit Win-Win. 2. Vendosija e një precedenti, të replikueshëm, në bashkitë e përzgjedhura nëpërmjet zhvillimit të projekteve konkrete zhvillimore me pjesëmarrjen e qytetarëve, përgjatë procesit të buxhetimit vjetor.	12	Librazhd, Përmet
10	Qendra e Gruas Hapa të Lehtë	Lëvizja Qytetare për Bashkëqeverisje	Ngritja e Bordit të Ekspertëve në nivel bashkie si instrument monitorues i zbatimit të Kontratës Sociale të realizuar gjatë zgjedhjeve të 2015. Anëtarët e Bordit, përveçse do jenë pjesëmarrës aktivë në mbledhjet e Bordit dhe të Këshillit Bashkiak Shkodër, ekspertiza e tyre në fusha të ndryshme që prekin jetën e qytetit, do përdoret për të informuar e sensibilizuar komunitetet në lidhje me çështje specifike. Gjithashtu, Bordi i Ekspertëve do të shërbejë edhe si instrument këshillues i politikave dhe vendimmarrjes në nivel lokal nëpërmjet rritjes së ndikimit të shoqërisë civile, konkretisht 10 grupeve komunitare nga ish-komunitat në hartimin dhe monitorimin e politikave lokale vendore. Do të synohet: a) Ngritja e kapaciteteve dhe konsolidimi i aftësive të shoqërisë civile mbi monitorimin e parimeve bazë të pjesëmarrjes në pushtetin vendor; b) Nxitja, përfshirja dhe pjesëmarrja e qytetarëve në në këshillin bashkiak si dhe monitorimin e tij.	12	Shkodër
11	Resurset Natyrore në Zhvillim	Zhvillim Ekonomik përmes pjesëmarrjes se komunitetit në vendimmarrje.	Institucionalizimi i pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje, në përcaktimin e përparësive të zhvillimit, planifikimit, hartimit të buxhetit dhe ofrimit të shërbimeve me cilësi e transparencë. Identifikimi i problemeve të qytetarëve nëpërmjet një anketimi dhe hartimi i një materiali që do paraqitet në Bashki dhe Këshillin Bashkiak për miratim dhe lobim për ta përfshirë në Strategjinë Zhvillimore dhe Buxhet Planin e vitit 2017 të Bashkisë Shkodër. Ngritja e kapaciteteve të 50 qytetarëve për funksionimin e pushtetit vendor dhe realizimi i një intershipsi në bashkëpunim me bashkinë Shkodër për 10 qytetarë të trjuanar për një periudhë një mujore në mënyrë që zëri qytetar të përçohet në brendësi të insitucioneve të pushtetit vendor.	10	Shkodër

PROJEKTET NË ZBATIM THIRRJA E 1 ^{RË}					
GRANT-MARRËSIT ORGANIZATA JO FITIM-PRURËSE					
Nr	Organizata	Projekti	Përshkrim i Shkurtër	Kohëzgjatja (muaj)	Zona e Zbatimit
12	Qendra Levizja Rinore per Demokraci	Aktivizimi Multimedial Rinor për Qeverisje Lokale të Mirë	Të rinjtë e bashkisë së re Pukë, në veçanti ata të zonës rurale, të jenë më aktiv dhe më mirë të përfaqësuar në axhendën e re lokale. a) Të rinjtë e Bashkisë së re Pukë do të jenë aftësuar për të monitoruar, advokuar dhe shprehur në mënyrë inovative dhe profesionale kërkesat për adresimin e nevojave dhe prioritetëve të tyre duke u bazuar tek Kontrata Sociale që është realizuar në zgjedhjet e 2015; b) Krijimi i një platforme multimediale për të rritur pjesëmarrjen e të rinjve në vendimmarrje si dhe për të nxitur debatin publik në shërbim të përmirësimit të politikave lokale; c) Rritja e nivelit të llogaridhënies dhe transparencës së zyrtarëve lokalë në lidhje me problematikat e të rinjve dhe komunitetit në përgjithësi nëpërmjet nxitjes së debatit publik në këtë bashki.	12	Pukë
13	Partnerë për Fëmijët	Advokaci Komunitare për Shërbime Sociale në Bashkinë Dibër	Fuqizimi i anëtarëve të komunitetit të Bashkisë Dibër në përmirësimin e ofrimit të shërbimeve sociale për të rinjtë dhe të rriturit në nevojë (përfshirë dhe Personat me Aftësi të Kufizuara). Nëpërmjet këtij projekti synohet: a) Zhvillimi dhe ngritja e kapaciteteve të grupit të të rinjve dhe të rriturve për të advokuar pranë strukturave të pushtetit lokal për ngritjen e një qendre ditore multi-funksionale dhe përmirësimin e aksesit ndaj shërbimeve sociale në Bashkinë Dibër. Për këtë aspekt do të ndihmojë hartimi i një Strategjie Advokuese për grupin e aktivistëve për të lobuar, advokuar dhe promovuar përmirësimin e shërbimeve sociale; b) Përmirësimi i ndarjes dhe shkëmbimit të informacionit midis qytetarëve dhe Sektorit të Shërbimeve Sociale në Bashkinë Dibër duke fuqizuar pjesëmarrjen qytetare dhe procesin e vendimmarrjes së pushtetit vendor.	9	Dibër
14	Streheza per Grate e Vajzat e Dhunuara	Të rinjtë për qeverisjen vendore	Projekti synon të angazhojë të rinjtë e Bashkisë së Bulqizës si aktorë të rëndësishëm në vendimmarrjen në nivel vendor për adresimin e problematikave të ndryshme sociale që shqetësojnë komunitetin e tyre nëpërmjet a) Fuqizimit të të rinjve në 8 njësitë administrative të Bashkisë Bulqizë përmes ngritjes së grupeve aktive dhe trajnimit të tyre. b) Mbështetjes së të rinjve për të identifikuar çështje të mprehta sociale të komuniteteve ku ata jetojnë (rurale dhe urbane) dhe hartimin e një studimi për vlerësimin e nevojave nga vetë të rinjtë. c) Rritjen e pjesëmarrjes së të rinjve aktivistë në qeverisjen vendore të Bashkisë Bulqizë, nëpërmjet hartimit të një plani bashkëpunimi me bashkinë dhe prezantimit të çështjeve sociale të identifikuara nga të rinjtë dhe që kërkojnë zgjidhje në Këshillin Bashkiak.	12	Bulqizë
15	Qendra per Ruajtjen e Ekosistemeve Natyrore ne Shqiperi (EcoAlbania)	Angazhimi i Komunitetit - Tregues i Integritimit në Vendim-marrje	Rritja e pjesëmarrjes aktive të publikut në vendim-marrje, për përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore. a) Përmirësimi i procesit të njoftimeve për dëgjesa publike, për dhënien e lejeve mjedisore të HEC-eve, në territorin e bashkive që shtrihen përgjatë luginës së lumit Vjosa. b) Rritja e pjesëmarrjes dhe e vetëdijes së komunitetit të luginës së Vjosës, mbi rolin e tyre në vendimmarrje për dhënien e lejeve mjedisore të HEC-eve. c) Vlerësimi i nivelit të reflektimit të shqetësimeve të komunitetit të luginës së Vjosës, në dëgjesa publike për dhënien e lejeve mjedisore të HEC-eve. d) Mbështetja e komunitetit të luginës së Vjosës në reagimet qytetare si pjesë e procesit të kërkesës së llogarisë ndaj institucioneve vendim-marrëse.	12	Përmet, Tepelenë, Mallakastër, Selenicë

PROJEKTET NË ZBATIM THIRRJA E 1^{RË}

GRANT-MARRËSIT INDIVIDË

Nr	Organizata	Projekti	Përshkrim i Shkurtër	Kohëzgjatja (muaj)	Zona e Zbatimit
16	Diana Malaj	Projekti "24601"	Projekti "24601" ka si qëllim parësor angazhimin rinor duke ndërmarrë iniciativa konkrete në hapjen e Pallatit të Kulturës në bashkinë Kamëz. Projekti synon: a) Krijimin e Këshillit Rinor i cili është i përbërë nga një rrjet Aktivistësh dhe ngritjen e grupit të monitorimit për funksionimin e Këshillit Bashkiak; b) Realizimi i disa aktiviteteve artistike dhe mbështetje për një grup vajzash si një mënyrë për të lobuar për hapjen e Pallatit të Kulturës (përmendim Klubin e Filimit, Klubin e Librit, FEMArt, shfaqje artistike) c) Monitorimi i projekteve me fokus rinor dhe iniciativat rinore të Bashkisë Kamëz.	10	Kamëz
17	Fatbardha Nergjoni	Transparenca dhe efektshmëria e programit "Buxhetim me pjesëmarrje" të bashkisë Elbasan përmes medias lokale dhe aktivizimit qytetar.	Rritja e transparencës dhe efektshmërisë së programit "Buxhetim me pjesëmarrje" në bashkinë Elbasan përmes medias lokale duke fuqizuar grupe qytetarësh të angazhuar për të ndikuar në vendimmarrje. a) Bërja transparente e procedurës së ndjekur dhe prioritetet të identifikuar e të realizuara për dy vite aplikim të programit Buxhetim me Pjesëmarrje nga Bashkia Elbasan deri në finalizimin e investimeve; b) Testimi i programit Buxhetim me Pjesëmarrje nëpërmjet realizimit të grup-intervistave, reportazheve dhe analizave në median lokale vizive dhe të shkruar; c) Fuqizim i qytetarëve më me ndikim në komunitet, identifikim të prioritetet nëpërmjet intervistimit të tyre dhe transmetimit në median lokale	12	Elbasan
18	Shpresa Blaceri	Qeverisje me dhe për Komunitetin	Përfshirja aktive e komunitetit në zhvillimet lokale, përmes bashkëpunimit konstruktiv dhe presionit të vazhdueshëm pozitiv mbi administratën duke ndërgjegësuar qytetarët pogradecarë për rolin e fuqishëm që ata kanë në shoqëri. a) Rigjallërimin e komunitetit përmes ndërgjegjësimit të tyre për potencialin e madh që kanë vetë ata për të marrë pjesë në vendim-marrje dhe për të ushtruar presion mbi administratën bashkiake e për ta vënë atë në shërbim të tyre e jo anasjelltas; b) Afësimin e komunitetit për të identifikuar objektivist nevojat prioritare; c) Advokim për planifikim në buxhetin e bashkisë të nevojave të identifikuar në 5 lagjet e qytetit.	7	Pogradec
19	Gentjan Hajdari	Bordi Rinor Këshillimor Vorë	Ky projekt ka për qëllim të axisë fuqizimin dhe pjesëmarrjen e të rinjve në proceset vendimmarrëse në Bashkinë e Vorës përmes krijimit të Bordit Rinor Këshillimor pranë Këshillit Bashkiak. a) Të nxitet pjesëmarrja e grupeve rinore, përfaqësuar nga Bordi Rinor Këshillimor pranë Bashkisë, për t'u dhënë zë dhe prioritet çështjeve të të rinjve dhe banorëve në nivel lokal; b) Të fuqizohet të rinjtë për të mbajtur të zgjedhurit publikë të përgjegjshëm në ushtrimin e funksioneve të tyre.	10	Vorë
20	Harilla Koci	Për një transparence në rritje të Qeverisjes Vendore	Përmirësimi i shërbimeve cilësore, në kohë, me efektivitet dhe në respekt të plote të ligjit të ofruara nga administrata e Bashkisë Vlorë në shërbim të qytetarëve të saj, përmes rritjes së aktivizimit qytetar dhe rolit të medias si përcues publik i tij. a) Krijimi i një dialogu konstruktiv midis qytetarëve, administratës së bashkisë, ekspertëve nga sistemet juridik, jeta akademike, biznesi, media dhe shoqëria civile për diskutimin e problematikave në interes të publikut (quadruple helix system); b) Krijimi i një modeli mediatik profesional diskutimi dhe debati në median lokale ku çdo palë ka të drejtë të shprehët, të dëgjohet dhe të respektohet duke rritur llogaridhënien e pushtetit vendor.	12	Vlorë
21	Raimond Kola	Platforma multimediale vendore në Gjirokastrë: "Qeverisje e Hapur"	Rritja e pjesëmarrjes së qytetarëve në politikë e qeverisësve të Bashkive nëpërmjet mjeteve multimediale mediatike, (Facebook, Blog, Revistë). Ndërgjegjësimi dhe ndihma praktike ndaj qytetarëve për marrjen e informacionit mbi bazë të Ligjit për të Drejtën e Informimit. a) Promovimi në nivel lokal i gazetarisë sociale për të siguruar dhe përmirësuar mbulimin e çështjeve sociale; b) Nxitja përmes Platformës Multimediale Qeverisje e Hapur e dialogut qeveri vendore -publik. c) Monitorimi i bashkive në fusha të ndryshme, publikimi në Platformën Multimediale i vendim-marrjeve të Këshillit Bashkiak dhe strukturave të tjera vendore.	12	Gjirokastrë, Libohovë.
22	Armisa Hoxha dhe Greta Tosku	Këshilli i Urtësisë	Rritja e gjatëpërfshirjes së qytetarëve në vendimmarrje dhe detyrimi i pushtetit vendor për të marrë masat e përcaktuara në legjislativonin në fuqi. a) Ngritja e Këshillit të Urtësisë në 6 nga njësi administrative rurale; b) Përfshirja e qytetarëve mbi 60 vjeç në këto këshilla dhe ndërvëprimi me ta për të marrë pjesë në Këshill; c) Pasqyrimi i zërit të qytetarëve në vendimmarrjen e Këshillit Bashkiak. Arritjen e një qeverisje të efektshme, efikase dhe në një nivel sa më afër qytetarëve; d) Realizimin e ndërvëprimit ndërmjet vetë organeve të njësisë të vetëqeverisjes dhe mbi të gjitha mes qytetarëve dhe këtyre organeve; e) Paraqitja e iniciativave qytetare për vendimmarrje në Këshillin Bashkiak.	12	Tiranë